



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 3736/1 Prishtinë 01.11. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI INFRASTRUKTURË RRUGORE

Studenti Albinë Tërnavë ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " Hipoteza dhe propabiliteti i paraqitjes së dëmtimeve në konstruksionin e rrugëve " në programin e studimeve Master Infrastrukturë Rrugore dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Ne praktikën inxhinierike shumë shpeshë bëhen kërkime dhe Hipoteza se sa ka Propabilitet të paraqiten demtime të konstruksioneve fleksibile.

Secili projekt në veçanti ka karakteristiake të veta, duke u nisur nga baza e shënimeve, ngarkesa dhe niveli i infrastrukturës që e karakterizon.

Hipotezat e vlerësimi të gjendjes së rrugëve dhe llogaritja e demtimeve të konstruksionit fleksibil bëhen me metodën e ndryshme, ku secila metodë ngërthen në vetë një set hapash që duhet të mirren parasysh me qëllim të vlerësimit dhe ndërmarrjes së hapave tjerë të ruajtjes së gjendjes së shërbyeshmërisë me sa më pak investime.

Me këtë rëndësi të madhe paraqet procesi i quajtur mirëmbajtje e rrugëve, që shërben për ruajtjen e elementeve të konstruksionit rrugor në aspektin e sigurisë dhe jetëgjatësisë së rrugëve. Kjo mund të arrihet nëse intervenohet me kohë dhe nëse nuk lejohet që dëmtimet e para të paraqitura në rrugë të vazhdojnë të shkatërrojnë atë edhe më tutje.

Efektet e kombinuara të ngarkesës së trafikut dhe mjedisit do të shkatërrojnë çdo rrugë, pa marrë parasysh se sa mirë është projektuar / ndërtuar pas një periudhe kohore. Kjo ndodhë për shkak të zvogëlimit të aftësisë mbajtëse të rrugës, lajmërimit të plasaritjeve, deformimeve, gropave si dhe kushteve klimatike.

Dëmtimet në konstruksione fleksibile, konkretisht dëmtimet e shtresës qarkulluese vijnësi pasojë e vjetërsisë së rrugëve, ngarkesave të trafikut, efekteve klimatike (temperaturat shumë të ulëta dhe shumë të larta), punimi i dobët i rrugës dhe materialet jo cilësore të përdorura gjatë ndërtimit.

Për të parandaluar dëmtimet e shtresave rrugore duhet të bëhet mirëmbajtja e rrugëve, procesi i ruajtjes, rehabilitimit dhe mbrojtjes së karakteristikave funksionale dhe konstruktive të rrugës.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.